



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA  
GJYKATA THEMELORE PRIZREN

---

Numri i lëndës: 2022:055387

Datë: 11.03.2024

Numri i dokumentit: 05433155

C.nr.1030/202

2

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, gjyqtari Uran Zogaj, me bashkëpunëtoreshen profesionale B.G. në çështjen juridike kontestimore të paditëses E.Xh. me numër personal ..... nga Prizreni, të cilën me autorizim e përfaqësojnë avokatët B.K. dhe F.G. që të dy nga Prizreni, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit, Prizren, me objekt të kontestit kompensimi i të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, vlera e kontestit 1,687.00 euro, jashtë shqyrtimit kryesor, më datë 11.03.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET pjesërisht e bazuar kërkesëpadia e paditëses E.Xh. nga Prizreni, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit, Prizren, për shkak të kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit.

II. DETYROHET e paditura, që paditëses, në emër të kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, për periudhën kohore prej datës 23.03.2019 deri më datë 30.04.2021 apo për 25 muaj e 8 ditë pune (për çdo muaj shumën prej 60.25 euro, në shkallë prej 27% të pagës bazë- 459.00 euro dhe për 8 ditë shumën prej 8.00 euro, në emër të diferencës së papaguar të kualifikimit ose licencimit), t'ia paguajë shumën e përgjithshme prej 1,522.25 euro, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, nga dita e parashtrimit të padisë më datë 23.03.2022 e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përbarimit të detyrueshëm.

III. REFUZOHET e pa bazuar, pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditëses, përtej shumës së gjykuar sikur në pikën II. të dispozitivit të aktgjykimit deri në shumën e kërkuar prej 1,687.00 euro, përkatësisht në shumën prej 164.75 euro, në emër të kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, për periudhën kohore prej datës 01.02.2019 deri më datë 22.03.2019.

IV. DETYROHET e paditura, që paditësit, t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 144.00 euro, në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësja E.Xh. nga Prizreni, të cilën sipas autorizimit e përfaqësojnë avokatët B.K. dhe F.G. që të dy nga Prizreni, pranë kësaj gjykate ka parashtruar padi, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit, Prizren, me objekt të kontestit kompensimi i të

ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, vlera e kontestit 1,687.00 euro.

Të autorizuarit e paditësit në padi, kanë theksuar se paditësja është e punësuar si mësimdhënëse pranë SHML “Remzi Ademaj” në Prizren, ku vazhdon të punojë në këtë institucion. Tutje, ka theksuar se për kualifikimin e paditësit me diplomë të fakultetit 3 apo 4 vjeçar, duhet të bëhet kompensimi shtesë prej 27% të vlerës së pagës bazë, e cila është 459 euro, apo shuma e gradimit 123.93 euro, ku aktualisht i paguhet vetëm shuma prej 63.68 euro, përkatësisht 60.25 euro në muaj më pak. Të njëjtit për 4 vite pune nga data 18.04.2017, e deri me datë 18.04.2021, janë bërë 48 muaj, të cilat shumëzohen me shumën prej 60.25 euro del shuma e përgjithshme prej 2,892.00 euro. Andaj, ka propozuar që të aprovohet e bazuar kërkesëpadija e paditësit, të detyrohet e paditura t’ia kompensojë shumën e përgjithshme prej 2,892.00 euro, në emër të kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, me kamatë ligjore prej 8%. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Paditësja përmes të autorizuarit të saj me parashtrësën e datës 09.11.2023 ka bërë precizimin e kërkesëpadijës meqenëse pala e paditur është thirrur në parashkrim dhe atë ka kërkuar nga gjykata kompensimin në emër të kualifikimit për periudhën kohore nga muaji i dytë i vitit 2019 deri në muajin e 4-të të vitit 2021, apo për 28 muaj, në shumën prej 1,687.00 euro.

E paditura, në përgjigjen në padi e ka kontestuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit si të pa bazuar, duke kërkuar që gjykata të njëjtën ta refuzoj si të pabazuar. Ka theksuar se pretendimi i paditësit se i takon kompensimi për licencim është në kundërshtim me nenin 2 par. 1.1 të Kontratës Kolektive të Arsimit, sepse në atë dispozitë shkruan se përfitues të të gjitha beneficioneve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit janë vetëm për anëtarët e Sindikatës së Arsimit – SBASHK-ut, ndërsa paditësi nuk ka paraqitur fakte se është anëtar i kësaj sindikate, nuk ka dëshmuar me anë të kartelës së anëtarësisë. Po ashtu ka theksuar se paditësi ka ushtruar padi në gjykatë për realizimin e të drejtave pa përfunduar procedura administrative, sepse nuk i ka vazhduar procedurat në Inspektoratin e Punës në Prizren, që do të thotë se paditësi nuk i ka shterur të gjitha mjetet juridike në procedurën administrative, ashtu që i janë drejtuar gjykatës në kundërshtim me nenin 124 par. 6.1. të Ligjit për Procedurën Administrative, dhe me këto veprime të paditurës i shkaktojnë shpenzime të mëdha, sepse obligohen të paguajnë edhe shpenzimet e procedurës gjyqësore. Sa i përket obligimit lidhur me përmbushjen e detyrimit, e paditura në përgjigjen në padi thekson se vet Komuna e Prizrenit nuk është nënshkruese e Kontratës Kolektive, përkatësisht Qeveria e Republikës së Kosovës është garantues i implementimeve të KKAK-së, andaj Komuna e Prizrenit nuk ka kod buxhetor për përmbushjen e obligimeve që burojnë nga KKAK-ja. E paditura ka kontestuar kërkesëpadinë duke u bazuar në nenin 87 të Ligjit të Punës, i cili decidivisht përcakton se, “kërkesa nga marrëdhënia e punës në para parashkruhen brenda 3 viteve, ndërsa në këtë rast padia është parashtruar më 28.03.2022, gjithashtu edhe sipas LMD-së neni 353, kjo e drejtë është parashkruar. Me të gjitha të cekurat si më lartë, e paditura ka kërkuar që kërkesëpadija e paditësit të refuzohet në tërësi si e pabazuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 398 dhe 399 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadija e paditësit është pjesërisht e bazuar, andaj pa shqyrtim të çështjes, e aprovoi pjesërisht kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Ndërmjet palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se paditësja E.Xh. është në marrëdhënie pune tek e paditura, si mësimdhënëse pranë Gjimnazit “Remzi Ademaj” në

Prizren. Mirëpo, kontestuese ishte nëse paditëses i takon e drejta e kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit si dhe nëse kërkesa e paditëses për kompensimin e të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit është parashkruar.

Në këtë drejtim, gjykata përmes kontratës së punës nr. 533/16 e datës 01.09.2016, e lidhur ndërmjet paditëses dhe të paditurës, gjykata vërtetoi faktin se paditësja është në marrëdhënie pune pranë të paditurës, kualifikimi i paditëses është kualifikim universitar, respektivisht e njëjta ka të përfunduar fakultetin e filologjisë, fakt i cili vërtetohet edhe nga Diploma me numër 1047, e datës 22.03.2007 e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Filologjisë, në emër të paditëses, ku e njëjta ka marrë titullin profesor në degën gjuhë dhe letërsi angleze. Në vazhdim, bazuar në listën e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, vërtetohet se lartësia e pagës bazë të paditësit është në shumë prej 459.00 euro dhe se paditësit në emër të kualifikimit fakultet, në pagën bazë mujore i është paguar shuma prej 63.68 euro.

Provat e lartcekura, gjykata i pranoi si provë materiale vendimtare, në kuptim të nenit 329 par. 1 të LPK-së, sipas së cilës dispozitë ligjore përcaktohet se “shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”. Andaj, meqë këto dokumente, përkatësisht kontrata e punës, licenca dhe lista e pagave janë të pranueshme edhe për vetë palën e paditur, pasi që të njëjtat nuk janë kontestuar, gjykata ia fali besimin e plotë.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë zbatohen dispozitat e Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33 të datës 29.08.2008. Kështu, në pikën 1. të këtij vendimi, përcaktohet që “nga 1 shtatori 2008 të gjithë mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional në shkollat e Republikës së Kosovës, do të kenë rritje të pagave të tyre në bazë të kriterëve të licencimit”. Ndërsa, në pikën 4. të vendimit në fjalë parashihet ngritja e pagës sipas shkallës apo nivelit të kualifikimit ose licencimit, në të cilën përcaktohet se “mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional, të pajisur: 1). Me diplomë të Shkollës Normale përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 10%; 2). Me diplomë të Shkollës së Lartë Pedagogjike përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 19%; 3). Me diplomë universitare 3 dhe 4 vjet përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 27% dhe 4). Me diplomë të ciklit të dytë dhe të tretë (Magjistraturë dhe Doktoraturë) përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 35%”. Pastaj, bazuar në mendimin juridik nr. 214/2023 të datës 09.10.2023, në pikën I. të tij përcaktohet që “për kërkesat e mësimdhënësve për kompensim mbi bazën e kualifikimit (licencimit), kompensimi bëhet sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara me Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33, datë 29.08.2008”, vendim i cili ka qenë në fuqi deri më 06.02.2023.

Në rastin konkret, gjykata gjeti se e paditura ka për detyrim, që paditësit t’ia paguaj kompensimin mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, konform detyrimeve që rrjedhin nga Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33, datë 29.08.2008, sipas shkallës apo nivelit të kualifikimit ose licencimit të përcaktuar në këtë vendim. Më konkretisht, nga lista e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, rezulton se e paditura, në emër të kualifikimit apo licencimit në pagën bazë, paditësit ia ka paguar shumën prej 63.68 euro. Sipas pikës 4 nën pikës 4 të Vendimit nr.01/33 të datës 29.08.2008, paditësja përfiton ngritje prej 27% të pagës bazë, që në rastin konkret paditësja përfiton ngritje në pagën bazë, në emër të licencimit apo kualifikimit shumën prej 123.93 euro.

Mirëpo, duke marrë parasysh që kërkesa e paditëses është parashtruar lidhur me pagën bazë në lartësi prej 459.00 euro, gjykata vendosi që paditëses i takon pjesa e diferencës së papaguar lidhur me pagën bazë në shumë prej 459.00 euro apo në shumë prej 60.25 euro. Në këtë drejtim, gjykata vendosi si në pikën nën I. dhe II. të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke e detyruar të paditurën që paditëses për çdo muaj t'ia paguaj shumën prej 60.25 euro, për periudhën kohore prej datës 23.03.2019 deri më datë 30.04.2021 apo për 25 muaj e 8 ditë pune, shumën e përgjithshme prej 1,522.25 euro. Pra, diferenca e papaguar në shumë prej 60.25 euro, duke e shumëzuar për 25 muaj ( $25 \times 60.25 = 1,506.25$  euro) dhe kjo diferencë duke e llogaritur për 8 ditë ( $2.00 \times 8 = 16.00$  euro) apo në mënyrë të përmblodhur ( $1,506.25 + 16.00 = 1,522.25$  euro).

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë më datë 23.03.2022, bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditur është vonuar në përmblodhjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Në anën tjetër, sa i përket pjesës refuzuese, gjykata e vlerësoi të bazuar pretendimin e palës së paditur lidhur me parashkrimin e kërkesës së palës paditëse. Kështu, sipas nenit 87 të LP-së shprehimisht theksohet që “të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”. Në këtë drejtim, paditësi padinë pranë kësaj gjykate e ka parashtruar më datë 23.03.2022, ndërsa kërkesa e tij ka qenë për kompensimin e të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit. Rrjedhimisht, duke vlerësuar afatin 3 vjeçar sipas nenit 87 të LP-së për parashkrimin e kërkesës në fjalë, gjykata erdhi në përfundim se paditësit iu ka parashkruar pjesa e kërkesës nga data 01.02.2019 deri më datë 22.03.2019. Më konkretisht, sipas llogaritjes së gjykatës, kërkesa e paditësit e cila është parashkruar rezulton të jetë në shumën prej 164.75 euro, bazuar në shumën e kërkuar nga pala paditëse dhe pjesës aprovuese sipas arsyeve të theksuara më lartë. Gjithashtu sa i përket periudhës kohore për të cilën është kërkuar kompensimi dhe atë nga 01.02.2019 deri me 30.04.2021 apo për 28 muaj, sipas llogaritjes së gjykatës bëjnë 27 muaj dhe jo 28, pra mbi këto dy baza është refuzuar një pjesë e kërkesës së paditëses.

Më saktësisht, gjykata vlerëson se përkundër faktit se paditësit e drejta për kompensimin e pagës shtesë mbi bazën e kualifikimit i është bërë e arritshme në fund të muajit- fillim të muajit, sipas nenit 87 të Ligjit të Punës, në mënyrë specifike dhe konkrete përcaktohet se kërkesat e tilla ndërpriten me rastin e parashtrimit të kërkesës- padisë, sipas nenit 369 të LMD-së. Kështu, paditësi ka ndërprerë rrjedhjen e parashkrimit dhe ka ruajtur të drejtën për të kërkuar realizimin e kërkesës së tij në procedurë gjyqësore nga data 23.03.2019 deri më datë 30.04.2021. Andaj, mbi këtë bazë gjykata aprovoi pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit sikurse në pikën nën I. dhe II. të dispozitivit të aktgjykimit, ndërsa pjesën tjetër e refuzoi të pabazuar sikurse në pikën nën III. të dispozitivit të aktgjykimit.

Gjykata me rastin e vendosjes jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në nenin 398 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton se “kur gjykata, pasi t'i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”. Po ashtu, gjykata vendosi jashtë seancës gjyqësore edhe në kuptim të nenit 399 par. 1 të LPK-së, pasi që pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditëses është e pabazuar në dispozita ligjore. Në këtë drejtim, sipas nenit

399 par. 1 të LPK-së parashihet që “kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadsisë, atëherë ajo do te jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia”.

Lidhur me kundërshtimet tjera të palës së paditur dhënë në përgjigje në padi, gjykata vlerësoi se të njëjtat nuk janë të bazuara në dispozita ligjore dhe nuk kanë mbështetje në ndonjë bazë faktike apo juridike, përpos kundërshtimit për parashkrim të cilën gjykata e vlerësoi të bazuar dhe e sqaroi më lartë. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit meritor.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë konform nenit 449, 452 dhe 453 par. 2 të LPK-së, duke obliguar të paditurën që në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore, paditësit t’ia paguajë shumën e përgjithshme prej 144.00 euro, sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, për përpilimin e padisë shumën prej 104.00 euro dhe për taksë gjyqësore shumën prej 40.00 euro.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me nenin 398 e 399 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN  
Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil  
C.nr.1030/2022, datë 11.03.2024

Gjyqtari  
Uran Zogaj

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit, pranë Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.